



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE DHE ASETIVE
SEKTORI I ASISTENCËS LIGJORE KONTRATAVE DHE ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Nr. 638 Prot.

Vau Dejës 17 09 .2026

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim dhe miratim.

Z. Ervis Shimaj

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK VAU DEJËS

I nderuar zoti Kryetar,

Bashkëngjitur po Ju dërgojmë projektvendimin, për:

“Për krijimin e Shoqërisë ‘Zadrima Green Energy’ SHA, si person juridik dhe miratimin e akteve të themelimit”

Me respekt,

KRYETARI
Kristian SHKRELI

ME VENDIM DELEGIMI

ZV/KRYETAR

Aleksandra GJONI

Konceptoi: Drejtor Ligjor

Marinela Deda



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE DHE ASETIVE
SEKTORI I ASISTENCËS LIGJORE KONTRATAVE DHE ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

PROJEKT VENDIM

Nr. 11 datë 17.09.2026

“PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË ‘ZADRIMA GREEN ENERGY’ SHA SI PERSON JURIDIK DHE AKTEVE TË THEMELIMIT”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, neni 9, pika 1.1 shkronja “b”, pika 1.6 shkronja “b”, nenit 54, shkronja “d” e ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar; ligjin nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, te ndryshuar; ligjin nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”, te ndryshuar, propozimin e Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës, i propozojmë Këshillit të Bashkisë, të:

VENDOSI

- Krijimin e Shoqërisë me emërtimin tregtare “Zadrima Green Energy” SHA, me objekt veprimtarie: zhvillimin, ndërtimin, instalimin, administrimin, operimin dhe mirëmbajtjen e impianteve për prodhimin e energjisë nga burime të rinovueshme dhe konkretisht Shoqëria do të ketë si objekt veprimtarie, ndër të tjera: prodhimin e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme, përfshirë energjinë diellore, eolike, hidrike dhe burime të tjera të rinovueshme; zhvillimin, ndërtimin, instalimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe impianteve fotovoltaike; zhvillimin dhe administrimin e projekteve për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme; shitjen dhe tregtimin e energjisë elektrike të prodhuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi; importin, eksportin, tregtimin dhe instalimin e pajisjeve dhe teknologjive që lidhen me prodhimin dhe përdorimin e energjisë së rinovueshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi; çdo veprimtari tjetër të lidhur me objektin e mësipërm, e cila nuk është e ndaluar nga ligji.
- Miratimin e aktit të themelimit dhe statusit të shoqërisë “Zadrima Green Energy” SHA. Të ngarkojë kryetarin e Bashkisë apo personin e autorizuar prej tij, që të nënshkruaje aktet e themelimit të kësaj shoqërie tregtare.
- Shoqëria “Zadrima Green Energy” SHA , organizohet dhe funksionon në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar; ligjin nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, te ndryshuar; ligjin nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”, te ndryshuar, dhe legjislacionit në fuqi.

- Kapitali i shoqërisë është 100 (njëqind) lekë. Pjesmarria e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tyre si vijon:
Lloji i kontributit është në natyrë në vlerën 100 (njëqind) lekë, 1 kuote, që përbën 100% vlerën e kapitalit themeltare të shoqërisë, që i përket Bashkisë Vau Dejës.
- Shoqëria "Zadrina Green" SHA, SHA të ketë selinë qendrore në adresën: Njesia Administrative Hajmel, Bashkia Vau Dejës, Shqipëri.
- Shoqëria "Zadrina Green" SHA, SHA të zhvillojë aktivitetin e saj për një afat të pacaktuar.
- Pas themelimit të saj, shoqëria regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas dispozitave të këtij ligji dhe të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".
- Shoqëria "Zadrina Green" SHA, ka në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së saj, të drejtën për të shqyrtuar dhe vlerësuar mundësinë e bashkëpunimit me shoqëri të tjera dhe të hyje në marrëdhënie kontraktuale me persona të tretë.
- Ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria Juridike e Prokurimeve dhe Aseteve për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

KRYETARI
Kristian SHKRELI

ME VENDIM DELEGIMI

ZV/KRYETAR

Aleksandra GJONI



Konceptoi: Drejtor Ligjor
Marinela Deda

STATUT I SHOQËRISË AKSIONARE

"ZADRIMA GREEN ENERGY" SH. A

Ky statut rregullon organizimin, anëtarësinë, kapitalin, qeverisjen dhe veprimtarinë ekonomike të shoqërisë "Zadrima Green" Sha, në përputhje me Ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar; ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar; ligjin nr. 24/2023, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme" të ndryshuar; ligjin nr. 59/2026, "Për sektorin e energjisë elektrike" të ndryshuar dhe legjislacionin tjetër të zbatueshëm.

KREU I – DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Forma Juridike

Shoqëria "Zadrima Green Energy" Sha do të funksionojë në formën e Shoqërisë Aksionare pa Ofertë Publike. Shoqëria është person juridik i së drejtës shqiptare dhe gëzon të drejtat e personit juridik nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Bizneseve. Shoqëria zhvillon aktivitetin në përputhje me Ligjin Nr.9901 dt14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Pjesa V, Titulli 1, dhe ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Regjistrimin e Biznesit".

Neni 2

Emërtimi dhe Themelimi

Emri i Shoqërisë është "Zadrima Green Energy" SH.A.

Shoqëria "Zadrima Green Energy" SH.A ka formën e shoqërisë aksionare me dy nivele dhe 100% zotëruese e aksioneve nga Bashkia Vau Dejës.

Neni 3

Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është zhvillimi, ndërtimi, instalimi, administrimi, operimi dhe mirëmbajtja e impianteve për prodhimin e energjisë nga burime të rinovueshme. Shoqëria do të ketë si objekt, ndër të tjera: prodhimin e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme, përfshirë energjinë diellore, eolike, hidrike dhe burime të tjera të rinovueshme; zhvillimin, ndërtimin, instalimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe impianteve fotovoltaike; zhvillimin dhe administrimin e projekteve për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme; shitjen dhe tregtimin e energjisë elektrike të prodhuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi; importin, eksportin, tregtimin dhe instalimin e pajisjeve dhe teknologjive që lidhen me prodhimin dhe përdorimin e energjisë së rinovueshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi; çdo veprimtari tjetër të lidhur me objektin e mësipërm, e cila nuk është e ndaluar nga ligji.

Neni 4

Kohëzgjatja

Shoqëria "Zadrima Green Energy" Sha themelohet për të ushtruar veprimtari në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me këtë statut për një afat të pacaktuar. Ky afat mund të ndryshohet një ose më shumë herë me vendim të asamblesë së aksionarëve.

Neni 5

Selia

Selia e Shoqërisë "Zadrima Green Energy" Sha ndodhet ne adresën: Zyrat e Njësise Administrative Hajmel.

Kreu II Kapitali i Shoqërisë

Neni 6

Kapitali i Rregjistruar

Kapitali i shoqërisë "Zadrima Green" Sha është 100 (njëqind) lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tyre si vijon:

Lloji i kontributit është në natyrë në vlerën 100 (njëqind) lekë, 1 kuotë, që përbën 100% vleren e kapitalit themeltare të shoqërisë, që i përket Bashkise Vau Dejës.

Kreu III Organet e Shoqërise

Neni 7

Organet e shoqërisë

Organet e Shoqërisë Aksionare janë:

- Asambleja e përgjithshme;
- Këshilli mbikëqyres
- Administratori/administratores
- Eksperti Kontabel i Autorizuar

Neni 8

Asambleja e Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga ky ligj, nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e Asamblesë së Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit. Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë: a. përcaktimin e politikave tregtare; b. ndryshime të statutit; c. emërimin e shkarkimin e administratorit dhe anëtarëve të këshillit mbikëqyres; d. emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; e. miratimin e skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" e "d" të kësaj pike; e. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; f. shpërndarjen e fitimeve vjetore; g. zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit të regjistruar; h. pjesëtimin e aksioneve dhe anulimin e tyre; i. ndryshime në të drejtat, që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta; j. perfaqësimin e shoqërisë në gjykimet ndaj organeve të administrimit; k. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë; l. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj; m. çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo statuti

Meqenëse shoqëria zotërohet nga një aksionar i vetëm, të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme ushtrohen nga po ky aksionar. Asambleja e aksionareve merr vendime pas shayrtimit të dokumenteve perkatëse, së bashku me raportin e administratorit, këshillit mbikëqyrës dhe raportin e ekspertit kontabel të autorizuar. Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja regjistrohen në regjistrin e vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Neni 9

Thirrja e asamblesë së Përgjithshme

Rastet e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme i parashikon Neni 136 i Ligjit Nr.9901, date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregatë".

Neni 10

Këshilli Mbikqyrës

Këshilli Mbikqyrës i Shoqërisë përbëhet nga 5 persona dhe emërohen për një periudhë 3 vjecare. Anëtarët e këshillit mbikqyrës zgjidhen nga asambleja e përgjithshme me shumicën e kërkuar në pikën 2 të nenit 145 të Ligjit, duke zbatuar afatin e emërimit, të përcaktuar në statut, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 3 vjet. Në emërimin e tyre anëtarët e Këshillit Mbikqyrës duhet të paraqesin në shoqëri deklaratat e papajtushmërisë së funksionit të tyre dhe respektojnë ndalesat ligjore. Anëtarët e këshillit mbikqyrës mund të rizgjidhen. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës nuk mund të jenë të punësuar në këtë shoqëri. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës të zgjedhur nga asambleja mund të shkarkohen në çdo moment nga kjo e fundit për shkaqe të përligjura

Neni 11

Kompetencat e Këshillit Mbikqyrës

Këshilli Mbikqyrës ushtron ato kompetenca të cilat janë parashikuar me ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregatë", me përjashtim të kompetencave që ligji dhe ky statut ia ka rezervuar Asamblesë së Përgjithshme të aksionareve ose administratorit të shoqërisë, dhe ka këto të drejta dhe përgjegjësi: a) të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratorët; b) të përgatisë, me kërkesë të Asamblesë së Përgjithshme, marrjen e masave, që janë në kompetencë të kësaj të fundit, të rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t'u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e asamblesë; c) të thërrasë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e shoqërisë; d) të kujdeset që shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit; e) të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë; f) të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecures së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga administratorët. g) Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e këshillit të administrimit për t'u paraqitur asamblesë së Përgjithshme, së bashku me një raport të këshillit të administrimit për miratim dhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar; h) të përcaktojë shpërblimin e administratorëve;

Në rastet e parashikuara në pikat 3, 4 e 5 të nenit 136 të këtij ligji, Këshilli Mbikqyrës duhet të thërrasë menjëherë asamblenë e përgjithshme, për të shqyrtuar nëse shoqëria duhet të priset ose për marrjen e masave të tjera të nevojshme e të përshtatshme.

Neni 12

Funksionimi i Këshillit Mbikqyrës

Këshilli Mbikqyrës zgjedh ndërmjet anëtarëve të tij një kryetar dhe një zëvendëskryetar, të cilët thërrasin mbledhjen e Këshillit dhe drejtojnë diskutimet.

Ata emërohen për të gjithë kohën e mandatit të tyre në Këshillin Mbikqyrës dhe mund të jenë të rizgjedhshëm. Këshilli Mbikqyrës mund të emërojë një sekretar jashtë anëtarëve të tij dhe i cakton këtij pagën.

Neni 13

Procesverbalet e Këshillit Mbikqyrës

Këshilli Mbikqyrës është përgjegjës për mbajtjen në libra të posaçëm të procesverbaleve: a) të gjithë takimeve të Këshillit Mbikqyrës; b) dhe të gjitha mbledhjeve të Këshillit Mbikqyrës dhe komiteteve të tij, përfshirë edhe emrat e Administratorëve të pranishëm në çdo mbledhje.

Neni 14

Administratori i Shoqërisë

Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizike si administratorë të shoqërisë, për një afat të përcaktuar në statut, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 3 vjet.

Administratorët e shoqërisë mund të rizgjidhen. Emërimi prodhon pasoja pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 15

Kompetencat e Administratorit të Shoqërisë

Administratorët kanë të drejtë dhe detyrohen: a) Të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë; b) Të përfaqësojnë shoqërinë tregtare; c) Të kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të ibrave kontabël të shoqërisë; d) Të pergatisin dhe të nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecures së veprimtarisë, të cilët ia paraqesin këshillit të administrimit për miratim, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, për t'u paraqitur më pas për miratim nga asambleja e përgjithshme; e) Të krijojnë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat, që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë; f) Të kryejnë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë, sipas parashikimeve të këtij ligji apo të ligjeve të tjera; g) Të raportojnë përpara këshillit të administrimit për zbatimin e politikave tregtare dhe, me realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë, për veprimtarinë e shoqërisë; h) Të kryejnë detyra të tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut. i) Të japë direktiva për administratorët për zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë; j) të miratojnë marrjen përsipër të detyrimeve me vlerë më të lartë se 5 per qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare, të çertifikuara, nëpërmjet nënshkrimit të huave apo emëtimit të obligacioneve apo instrumenteve të tjera të borxhit; k) Të vendosë krijimin e bashkëpunimeve tregtare afatgjata dhe propozimin e politikave, për themelimin e shoqërive tregtare ose të grupeve të reja; l) të kryejë veprimet e tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut. Detyrat, që i cakton ligji këshillit të administrimit, nuk mund t'u delegohen administratorëve. Në rastet e parashikuara në pikat 3, 4 e 5 të nenit 136 të këtij ligji, administratorët duhet të informojnë menjëherë kryetarin e këshillit të administrimit.

Administratori ka të drejtë; a) Që brenda kompetencave të tij t'u japë një ose disa punonjësve të kompanisë, të drejten për të kryer veprime të veçanta apo kategori veprimesh, me të drejten e nëndelegimit. b) për të vepruar në emër të shoqërisë

Neni 16

Eksperti Kontabël i Autorizuar

Asambleja e Përgjithshme e Aksionareve cakton një Ekspert Kontabel të Autorizuar i zgjedhur nga lista e Institutit të Eksperteve Kontabel të Autorizuar.

Shpërblimi i tij caktohet nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionareve dhe përballohet nga Shoqëria, në përputhje me tarifën orare të miratuar nga Instituti i Ekspertëve Kontabel të Autorizuar (IEKA).

Asambleja e Aksionareve mund t'u kërkojë Eksperteve Kontabel të Autorizuar kryerjen e kontrolleve apo verifikimeve të posaçme për çështje në interes të Shoqërisë.

Neni 17

Përfundimi i aktivitetit:

Shoqëria "Zadrima Green Energy" SHA prishet:

1. Për pamundësi të objektit të saj
2. Me vendim të gjykatës
3. Me hapjen e procedurave të falimentimit.

Neni 18

Likuidimi

Likuidimi i shoqërisë aksionare do të bëhet sipas normave të legjislacionit shqiptarë në fuqi në kohën e likuidimit.

Neni 19

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësorë.

Neni 20

Hyrja në fuqi

Statuti hyn në fuqi pas miratimit nga themeluesi dhe regjistrimit të SHBB-së.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE DHE ASETIVE
SEKTORI I ASISTENCËS LIGJORE KONTRATAVE DHE ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Nr. — Prot

Vau Dejes, 17.09.2026

RELACION

“PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË ‘ZADRIMA GREEN ENERGY’ SHA, SI PERSON JURIDIK DHE AKTEVE TË TEMELIMIT”

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Vau Dejës

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, neni 9, pika 1.1 shkronja “b”, pika 1.6 shkronja “b”, nenit 54, shkronja “d” e ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar; ligjin nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” të ndryshuar; ligjin nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar; Drejtoria Juridike e Prokurimeve dhe Aseteve i parashtronë Këshillit Bashkiak relacionin si me poshtë vijon:

Në bazë të nenit 9, pika 1.6, të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, bashkitë si persona juridik, gëzojnë dhe ushtrojnë të gjitha të drejtat e përcaktuara në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë dhe në legjislacionin në fuqi, e ku njëra prej këtyre të drejtave konsiston në mundësinë e krijimit të personave të tjerë juridik.

Gjithashtu, ligji nr.9901, date 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, parashikon që edhe njesitë e vetëqeverisjes vendore të kenë në pronësi të tyre shoqëri që zhvillojnë veprimtari tregtare, me interes të përgjithshëm ekonomik, dhe ku themelimi, organizimi e funksionimi i të cilave iu nënshtrohen dispozitave të këtij ligji.

Qëllimi i shoqërisë “Zadrime Green Energy” SHA është zhvillimi, realizimi dhe administrimi i investimeve në fushën e energjisë nga burimet e rinovueshme, me fokus të veçantë në shfrytëzimin e energjisë diellore për prodhimin e energjisë elektrike në territorin e Bashkisë Vau Dejës. Shoqëria synon të kontribuojë në përdorimin eficient dhe të qëndrueshëm të potencialit energjetik të territorit të Bashkisë Vau Dejës, nëpërmjet zhvillimit të një parku fotovoltaiik dhe infrastrukturës së nevojshme për funksionimin e tij. Nëpërmjet veprimtarisë së saj, shoqëria synon të nxisë zhvillimin ekonomik vendor, të krijojë burime të qëndrueshme të ardhurash, të rrisë përdorimin e energjisë së prodhuar nga burimet e rinovueshme, të kontribuojë në mbrojtjen e mjedisit, si dhe të krijojë mundësi për realizimin e investimeve dhe projekteve të reja në sektorin e energjisë së rinovueshme. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, eficiencës ekonomike, mbrojtjes së mjedisit dhe përdorimit racional të burimeve, duke respektuar legjislacionin në fuqi për

vetëqeverisjen vendore, shoqëritë tregtare, energjinë elektrike, burimet e rinovueshme të energjisë, mbrojtjen e mjedisit, planifikimin dhe zhvillimin e territorit dhe çdo fushë tjetër të zbatueshme.

Kapitali Kapitali i shoqërisë është 100 (njëqind) lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tyre si vijon:

Lloji i kontributit është në natyrë në vlerën 100 (njëqind) lekë lekë, 1 kuote, që përbën 100% vlerën e kapitalit themeltare të shoqërisë, që i përket Bashkisë Vau Dejës.

Organizimi i strukturave të shoqërisë do të realizohet në përputhje me parashikimet e ligjit nr.9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar. Organet shoqërisë janë si më poshtë vijon:

- a. Asambleja e përgjithshme;
- b. Këshilli mbikëqyres
- c. Administratori/administratores
- d. Eksperti Kontabel i Autorizuar

Nga pikëpamja e aktivitetit që do të ushtroje shoqëria ajo do të funksionojë si një strukturë e specializuar në zhvillimin, ndërtimin, instalimin, administrimin, operimin dhe mirëmbajtjen e impianteve për prodhimin e energjisë nga burime të rinovueshme dhe konkretisht Shoqëria do të ketë si objekt veprimtarie, ndër të tjera: prodhimin e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme, përfshirë energjinë diellore, eolike, hidrike dhe burime të tjera të rinovueshme; zhvillimin, ndërtimin, instalimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe impianteve fotovoltaike; zhvillimin dhe administrimin e projekteve për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme; shitjen dhe tregtimin e energjisë elektrike të prodhuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi; importin, eksportin, tregtimin dhe instalimin e pajisjeve dhe teknologjive që lidhen me prodhimin dhe përdorimin e energjisë së rinovueshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi; çdo veprimtari tjetër të lidhur me objektin e mësipërm, e cila nuk është e ndaluar nga ligji.

Territori i Bashkisë Vau Dejës paraqet potencial për zhvillimin e projekteve të lidhura me prodhimin e energjisë nga burime të rinovueshme. Krijimi i një shoqërie tregtare në pronësi të plotë të Bashkisë krijon mundësinë që këto aktivitete të zhvillohen nëpërmjet një subjekti juridik të posaçëm, me kapacitet për të lidhur marrëdhënie kontraktuale, për të realizuar investime, për të administruar projekte dhe për të ushtruar veprimtari ekonomike në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Duke ju falenderuar, ju ftojme në miratimin e këtij materiali,

KRYETARI
Kristian SHKRELI

ME VENDIM DELEGIMI
ZV/KRYETAR
Aleksandra GJONI

Konceptoi: Drejtor Ligjor
Marinela Deda



AKTI I THEMELIMIT I SHOQËRISË AKSIONARE

ZADRIMA GREEN ENERGY SH.A

Sot, më _____.2026, në Vau Dejës, në mbështetje të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar dhe legjislacionit në fuqi, themeluesi Bashkia Vau Dejes vendosi të themelojnë një Shoqëri Aksionare.

KREU I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja dhe Selia e Shoqërisë

Neni 1

Themelimi

Themelohet shoqëria aksionare me emerin "ZADRIMA GREEN ENERGY" SH.A në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar; ligjin nr. 24/2023, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme" të ndryshuar; ligjin nr. 59/2026, "Për sektorin e energjisë elektrike" të ndryshuar.

Shoqëria është një entitet ligjor shqiptar dhe ka formën ligjore të një shoqërie aksionare (SH.A)

Themeluesi i Shoqërise "Zadrime Green" Sha, është:

Bashkia Vau Dejes, me NIPT K567050070 me adresë "Rruga Qafa e Gurit" Vau Dejës.

Neni 2

Objekti i Shoqërisë

Nga pikëpamja e aktivitetit që do të ushtrojë shoqëria ajo do të funksionojë si një strukturë e specializuar në zhvillimin, ndërtimin, instalimin, administrimin, operimin dhe mirëmbajtjen e impianteve për prodhimin e energjisë nga burime të rinovueshme, konkretisht Shoqëria do të ketë si objekt veprimtarie, ndër të tjera: prodhimin e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme, përfshirë energjinë diellore, eolike, hidrike dhe burime të tjera të rinovueshme; zhvillimin, ndërtimin, instalimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe impianteve fotovoltaike; zhvillimin dhe administrimin e projekteve për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme; shitjen dhe tregtimin e energjisë elektrike të prodhuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi; importin, eksportin, tregtimin dhe instalimin e pajisjeve dhe teknologjive që lidhen me prodhimin dhe përdorimin e energjisë së rinovueshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi; çdo veprimtari tjetër të lidhur me objektin e mësipërm, e cila nuk është e ndaluar nga ligji.

Neni 3

Kohëzgjatja

shoqëria "Zadrima Green Energy" Sha. themelohet për të ushtruar veprimtarinë në përputhje me legjislacionin në fuqi për një afat të pacaktuar. Ky afat mund të ndryshohet një ose më shumë herë me vendim të asamblesë së aksionarëve.

Neni 4

Selia

Selia e Shoqërisë "Zadrima Green Energy" Sha. ndodhet në adresën: Zyrat e Njësise Administrative Hajmel.

Kreu II Kapitali i Shoqërisë

Neni 5

Kapitali i Rregjistruar

Kapitali i shoqërisë "Zadrima Green" Sha është 100 (njëqind) lekë. Pjesmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tyre si vijon:

Lloji i kontributit është në natyrë në vlerën 100 (njëqind) lekë, 1 kuotë, që përbën 100% vlerën e kapitalit themeltare të shoqërisë, që i përket Bashkisë Vau Dejës.

Kreu III Organet e Shoqërise

Neni 6

Organet e shoqërisë

Organizimi i strukturës së shoqërisë do të realizohet në përputhje me parashikimet e ligjit nr.9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar. Organet vendimmarrëse të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

- a. Asambleja e përgjithshme;
- b. Këshilli mbikëqyres
- c. Administratori/administratores
- d. Eksperti Kontabel i Autorizuar

Detyrat dhe kompetencat e organeve janë të përcaktuara në mënyrë të detajuar tek ligji nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar dhe Statuti i Shoqërisë "Zadrima Green Energy" Sha.

Neni 7

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje, kundërshtim apo pretendim që mund të lindë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së Shoqërisë duhet të zgjidhet fillimisht me mirëkuptim. Nëse mosmarrëveshja nuk zgjidhet me mirëkuptim, mbetet në kompetencë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë.

Neni 8

Dispozita Përfundimtare

Ky akt themelimi është hartuar në tri (3) kopje me vlerë të njëjtë me origjinalin.

Për çdo çështje që nuk trajtohet në këtë Akt Themelimi, palët do t'i referohen dhe do të zbatojnë dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" siç është plotësuar dhe ndryshuar me vonë, ose çfarëdo ligji tjetër të zbatueshëm i cili është në fuqi.

Vau Dejës më _____.____.2026.

THEMELUESI